

AKTET E PAGESAVE

- Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar <http://ama.gov.al/legjislacioni/ligje/>
- Vendimi AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”; <http://ama.gov.al/akte-nen-ligjore-te-miratuara/>
- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- <http://ama.gov.al/legjislacioni/ligje/>
- Udhëzimi i Përbashkët nr. 32, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive”.
- <http://ama.gov.al/legjislacioni/ligje/>

LLOJET E PAGESAVE

1) Bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, llojet e pagesave janë:

- a. pagesë për marrje licence dhe/ose autorizimi;
- b. pagesë vjetore për licencë dhe/ose autorizim;
- c. pagesë për përpunim aplikimi, dokumentacioni, ndryshime në licencë dhe/ose autorizim.

2) Bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lloji i tarifës është:

a. tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive (*kjo pagesë aplikohet në subjektet e licencuara*).

** Pagesat/tarifat e sipërcituara kryhen në llogaritë bankare të AMA-s dhe janë të parimbursueshme.*

Bazuar në pikën 3.3, Kreu III “Pagesa për shërbimet e AMA-s” të Vendimit të AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 të sipërcituar, masat e pagesave janë si më poshtë:

a) Tarifa e shërbimit për lëshimin e dokumentacionit nga Arkiva e AMA-s,
për çdo fletë të fotokopjuar

15 lekë

b) Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të transkriptuara,

(për çdo fletë) 1,000 lekë

c) Tarifa e shërbimit për lëshimin e materialeve autentike të kaluara në DWD 1,400 lekë

Nga detyrimi për pagesën e marrjes së materialeve autentike të kaluara në DWD, përjashtohen:

- Studenti në rastin e përdorimit të tyre për nevoja studimore, për regjistrime deri në 2 orë;
- Institucionet me të cilat AMA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi;
- Çdo person, i cili pretendon se dinjiteti dhe reputacioni i tij janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim:

d) Shpenzimet e monitorimit të frekuencave që do të bëhet me kërkesë të subjekteve, do të likuidohen nga subjekti i cili e kërkon këtë shërbim, në bazë të një preventivi të përgatitur nga AMA dhe të miratuar nga subjekti.

e) Shpenzimet e monitorimit të programeve që do të bëhet me kërkesë të subjekteve, do të likuidohen nga subjekti i cili e kërkon këtë shërbim, në bazë të një preventivi të përgatitur nga AMA dhe të miratuar nga subjekti.

**Tarifat e sipërcituara kryhen në llogaritë bankare të AMA-s ose cash pranë AMA-s dhe janë të parimbursueshme.*

Llogaritë bankare të AMA-s janë si më poshtë:

1. Banka Credins: Nr. 458017, IBAN: AL12 2121 1157 0000 0000 0045 8017

2. Banka Raiffeisen: Nr. 0100007029, IBAN: AL38 2021 1013 0000 0001 0000 7029

3. Banka Kombëtare Tregtare (BKT): Nr. 402947044, IBAN: AL73 2051 1021 9470 44CL
PBCL ALLA